



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

Zyra e Rregullatorit për Energji

Parimet e përcaktimit të ngarkesave për shpërndarje

2012



Pjesa I – Dispozitat e përgjithshme	3
Neni 1 - Hyrje	3
Neni 2 - Fushëveprimi dhe qëllimet	3
Neni 3 - Përkufizimet dhe interpretimi	3
Pjesa II – Parimet e përbashkëta	5
Neni 4 - Mos diskriminimi dhe pasqyrimi i kostos	5
Neni 5 - Thjeshtësia dhe transparenca	6
Pjesa III - Shfrytëzimi i metodologjisë së përcaktimit të ngarkesave për sistemin	6
Neni 6 - Metodologjia e përcaktimit të ngarkesave për DUOS: Kërkesat minimale	6
Neni 7- Baza e përcaktimit të ngarkesave	7
Neni 8 - Ndarja e kostos për shfrytëzim të sistemit	7
Neni 9 - Kostot e rikthyeshme	8
Neni 10 - Oferta e kushteve për shfrytëzim të shërbimeve të sistemit	8
Pjesa IV – Kyçja në sistem	8
Neni 11 - Metodologjia e përcaktimit të ngarkesave: Kërkesat minimale	9
Neni 12 - Kyçja e gjeneratorit	10
Neni 13 - Kyçjet e ngarkesave	11
Neni 14 - Përcaktimi i ngarkesave për kyçje	11
Neni 15 - Oferta e Kushteve për kyçje	11
Pjesa V - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE	12
Neni 16 - Gjuha zyrtare	12
Neni 17 - Ndryshimi	12
Neni 18 - Interpretimi	12



PJESA I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Hyrje

Këto parime mbi llogaritjen e ngarkesave të shpërndarjes (me tutje “Parimet”) janë lëshuar nga Rregullatori në përputhje me kompetencat e dhëna në Nenin 14 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185 Bordit të Rregullatorit për të aprovuar metodologjitë e tarifave të zhvilluara nga Operatori i sistemit të shpërndarjes për ngarkesat e vëna në lidhje me shërbimet e tyre të rregulluara.

Neni 2

Fushëveprimi dhe qëllimet

1 Këto parime i përcaktojnë:

- a) Parimet mbi të cilat OSSH duhet të hartojë propozimet për ngarkesat për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes (“metodologjia e përcaktimit të ngarkesave për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes”), dhe
- b) Parimet mbi të cilat OSSH duhet të hartojë propozimet për përcaktimin e taksave për kyçje në Sistemin e Shpërndarjes (“Metodologjia për përcaktimin e taksave për kyçje në sistemin e shpërndarjes”)

të cilat do t’i parashtrihen Rregullatorit për aprovim. Bordi i rregullatorit pret që metodologjitë e propozuara të jenë në pajtim me këto parime. Në të kundërtën, Bordi i Rregullatorit do të kërkojë një arsyetim të plotë dhe të detajuar për këto mospërputhje në mënyrë që të vendosë lidhur me aprovimin këtyre Metodologjive.

2 Këto Parime duhet të jenë në përputhje me Kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, Pjesa III, dhe me Rregullin mbi përcaktimin e çmimeve të shpërndarjes.

Neni 3

Përkufizimet dhe interpretimi

1 Shprehjet në këtë Rregull kanë kuptimet që janë përcaktuar me Ligjin për rregullatorin e energjisë, Ligjin për energjinë, Ligjin për energjinë elektrike, në Rregullën për përcaktimin e çmimeve të OSSH-së apo në Kushtet e përgjithshme të furnizimit.

1.1 “parashtruesi i kërkesës” do të thotë një person fizik apo juridik i cili i kërkon OSSH-së të



bëjë lidhjen e re apo të ndryshuar në rrjetin e shpërndarjes;

- 1.2 “thellë” në raport me lidhjen nënkupton se parashtruesi i kërkesës me shpenzimet e veta ofron apo paguan direkt kostot e asetëve të nevojshme për kyçje në pikën më të afërt të përshtatshme të lidhjes në sistemin ekzistues të shpërndarjes plus çfarëdo kostosh indirekte që shkaktohen nga punë të ndërlidhura me përfundimin, zgjerimin apo ri-konfigurimin e rrjetit ekzistues e të cilat janë shkaktuar si pasojë direkte e krijimit të kyçjes;
- 1.3 “kapaciteti efektiv” do të thotë kapaciteti total në secilin pikë të rrjetit i cili është në dispozicion për t’u shfrytëzuar nga shfrytëzuesit pa i thyer limitet teknike të operimit të rrjetit. Mund të klasifikohet duke iu referuar çfarëdo kriteri teknik përkatës apo standardeve në fuqi duke përfshirë por duke mos u kufizuar në, kapacitetin aktual të bartjes, kapacitetin me qark të shkurtër, limitet e tensionit apo limitet e stabilitetit;
- 1.4 “TU” ose “tensioni i ulët” nënkupton tensionin i cili nuk tejkalon 1000 Volt të rrymës së ndryshueshme;
- 1.5 “TL” do të thotë tensioni i shpërndarjes më i lartë se 1000 Volt të rrymës së ndryshueshme;
- 1.6 “cekët” në raport me lidhjen nënkupton se parashtruesi i kërkesës me shpenzimet e veta ofron apo paguan ato kosto direkte që shkaktohen nga krijimi i një lidhjeje të re në pikën më të afërt të përshtatshme të rrjetit ekzistues të shpërndarjes;
- 1.7 “Taksa standarde për kyçje” do të thotë taksa që kërkohet nga parashtruesi individual i kërkesës e cila është llogaritur për të pasqyruar koston mesatare për krijimin e lidhjeve të ngjashme për atë klasë të parashtruesit të kërkesës.
- 1.8 “Shfrytëzuesi” ka kuptimin e njëjtë si ai në Kodin e shpërndarjes.



PJESA II – PARIMET E PËRBASHKËTA

Neni 4

Mos diskriminimi dhe pasqyrimi i kostos

1 Në hartimin e Metodologjisë së përcaktimit të ngarkesave të paraparë në Nenin 2 më lartë, OSSH duhet të ngarkojë ose ofron të ngarkojë me çmim cilin do person për ndonjë kyçje apo shfrytëzim të sistemit, i cili:

- a) nuk dallon materialisht nga ato të cilat ngarkohen apo i ofrohen ndonjë personi tjetër i cili parashtron kërkesë për një shërbim të ngjashëm; dhe
- b) pasqyron , në masë të arsyeshme, kontributin që jep personi i tillë për koston e përgjithshme të ofrimit të shërbimit të kërkuar.

2 Pa marrë parasysh kushtin e përgjithshëm të pasqyrimin të koston në strukturën e ngarkesave, OSSH mund të përcaktojë taksa mesatare apo të standardizuara për kyçje apo ngarkesa për shfrytëzim të shërbimeve të sistemit nga cilado klasë e shfrytëzuesve ku:

- a) shfrytëzuesit përbrenda asaj klase, bazuar mbi karakteristikat e kërkesës së tyre, në kuptim të gjerë janë të ngjashëm për nga kostot të cilat i shkaktojnë OSSH-së (duke marrë parasysh vëllimet relevante, faktorët e ngarkesës, formën e ngarkesës, kushtet e ndërprerjes, lokacioni i stabilimenteve në të cilat kryhen shërbimet, data dhe kohëzgjatja e ndonjë marrëveshjeje mbi sistemin si dhe çfarëdo informatash të tjera relevante);
- b) caktimi i çmimit specifik për shfrytëzuesit përbrenda asaj klase do të çonte në kosto më të mëdha administrative për OSSH pa ndonjë përfitim materialisht të kompensueshëm për shfrytëzuesit sa i përket transparencës; dhe
- c) Çmimi i tillë mesatar ka pak gjasa të shkaktojë ndonjë barrierë për konkurrencën.

Neni 5

Thjeshtësia dhe transparencia

1 Ngarkesat duhet të jenë sa më të thjeshta, transparente dhe të parashikueshme që të jetë e mundur, krahas pasqyrimin të nevojës për të çuar në optimum shfrytëzimin e rrjetit dhe të pasqyrojë shpenzimet e shaktuara në emër të sistemit dhe për shfrytëzues të caktuar dhe të shmang sa më shumë që jetë e zbatueshme rrezikun për vendimet e shtrembëruara për investim.

2 Ngarkesat duhet të marrin parasysh zhvillimet e ardhshme në strukturën e sektorit të energjisë elektrike dhe të lejojnë rregullim më të sofistikuar krahas zhvillimit të tregut.



PJESA III – SHFRYTËZIMI I METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË NGARKESAVE PËR SISTEMIN

Neni 6

Metodologjia e përcaktimit të ngarkesave për DUOS: kërkesat minimale

Metodologjia e përcaktimit të ngarkesave duhet t'u mundësojë shfrytëzuesve të sistemit që të bëjnë një vlerësim të arsyeshëm mbi ngarkesat në fuqi për DUOS dhe duhet të përfshijnë,

- a) Bazën mbi të cilën do të llogariten ngarkesat për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes;
- b) Bazën mbi të cilën do të bëhen ngarkesat e veçanta për kapacitetin në qarqet e shpërndarjes të sistemit të shpërndarjes;
- c) Listën e çfarëdo ngarkese që mund të kërkohet për ofrimin dhe instalimin e njehsorëve, përfshirë njësorëtkontrollues, apo ndonjë impiant elektrik në pikat hyrëse apo dalje, të cilat ndihmojnë dhe janë të domosdoshme për lejimin e shfrytëzimit të sistemit dhe për mirëmbajtjen e njësorvedhe impianteve të tilla;
- d) Kriteret mbi të cilat merret vendimi i OSSH-së për të refuzuar qasjen në sistem, kritere këto të cilat duhet të jenë objektive dhe teknikisht e ekonomikisht të arsyetuara.

Neni 7

Baza e përcaktimit të ngarkesave

- 1 Në përcaktimin e bazës së duhur për përcaktimin e ngarkesave për shfrytëzuesit për përdorimin e sistemit në kuptim të Nenit 6.1 a) OSSH duhet të merr parasysh kostot afatmesme të mirëmbajtjes së një sistemi të sigurt, të siguruar dhe të besueshëm në mënyrë që të përmirësohet parashikueshmëria, stabiliteti dhe pasqyrimi i çmimeve në aspektin afatgjatë.
- 2 Në hartimin e Metodologjisë për përcaktimin e ngarkesave për shfrytëzim të sistemit, OSSH duhet të merr parasysh kostot afatgjate, margjinale, kostot e shmangura të rrjetit që shkaktohen nga gjenerimi i shpërndarë dhe nga masat për menaxhimin e anës së kërkesës.¹

¹ DIREKTIVA 2003/54/EC E PARLAMENTIT EVROPIAN më datë 26 qershor 2003, pajkoja e dytë, preambula paragrafi 18



Neni 8

Ndarja e kostos për shfrytëzim të sistemit

- 1 Metodologjia duhet të respektojë parimet vijuese të politikës:
 - a) OSSH duhet të rikthejë ngarkesat përmes një koeficienti prej 0% ndaj gjenerimit dhe 100% ndaj kërkesës.
 - b) Ngarkesat duhet të përcaktohen në mënyrën e cila mundëson reflektimin e kostos për ofrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të shpërndarjes, të disponueshëm në nivele të ndryshme të tensionit
 - c) Nga shfrytëzuesit nuk duhet të pritet që të paguajnë për kostot kapitale, operative apo të mirëmbajtjes në lidhje me asetet të cilat nuk i shfrytëzojnë. Për shembull, kjo nënkupton që shfrytëzuesit të kyçur në sistem në tension më të lartë të shpërndarjes nuk do t'u kërkohej që të paguajnë për ofrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të tensionit që është më i ulët sesa tensioni i kyçjes së tyre.
 - d) Ngarkesat duhet të pasqyrojnë kostot që i shkaktohen, ose që vlerësohet se i shkaktohen sistemit nga shfrytëzuesi apo nga klasa e shfrytëzuesit në kohën e pikut (kërkesës më të lartë) në sistem.

Neni 9

Kostot e mbulueshme

- 1 Deri në përmasat e të cilave kostoja e tillë mund t'i ngarkohet shfrytëzuesit (ose në rast të ngarkesave mesatare, një klase të shfrytëzuesve), ngarkesat për shfrytëzim të sistemit mund të përcaktohen për të mbuluar:
 - a) Kostot kapitale dhe të punës për mirëmbajtjen e një sistemi të sigurt, të siguruar dhe të besueshëm, në përputhje me standardet kombëtare në fuqi² që vlejné për transportin e energjisë elektrike nga pika hyrëse e shfrytëzuesit deri të pika dalëse, dhe atë deri në masën ku këto kosto nuk mund të rikthehen nga ndonjë ngarkesë tjetër;
 - b) Kostot e mirëmbajtjes së tensionit dhe frekuencës në kuadër të kufijve kombëtar në fuqi;
 - c) Kostot e humbjes në distribucion (si teknike ashtu edhe komerciale) në formën e furnizimeve shtesë të nevojshme për t'i mbuluar këto humbje në distribucion;
 - d) Kostot e ofrimit, instalimit dhe mirëmbajtjes së njehsorëve relevant, deri në masën ku këto kosto nuk rikthehen nga ndonjë ngarkesë tjetër; dhe

² Terminologjia që përdoret në vend të "të aprovuar nga ZRRE" për të lejuar transponim të menjëhershëm të standardit që parashtrohet nga EnCT ose, në rast të transmisionit, ENTSO-E



- e) Çfarëdo kosto tjetër të cilën, kohë pas kohe, Rregullatori mund ta aprovojë si të mbulueshme përmes sistemit të ngarkesave ashtu siç është përcaktuar në Rregullin e Çmimit të OSSH-së.

Neni 10

Oferta e kushteve për shfrytëzim të shërbimeve të sistemit

- 1 Në kërkesën e parashtruar nga ndonjë person, OSSH duhet të ofroj të lidh marrëveshje për ofrimin e shfrytëzimit të shërbimeve të sistemit.
- 2 Oferta në paragrafin 1 duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë [30] ditë kalendarik pas pranimit të kërkesës për kyçje në rrjetin me tension të ultë dhe nëntëdhjetë (90) ditë kalendarik për kyçje në rrjetin me tension të mesëm apo të lartë.
- 3 Oferta për të vënë në dispozicion shfrytëzimin e shërbimeve të sistemit duhet të përcakton pikat e hyrjes në sistem, pikat e daljes nga sistemi dhe sasinë që kërkohet të transportohet, të gjitha shërbimet tjera të cilat mund të kërkohen me kërkesë, dhe duhet të përcakton çmimet që duhet të paguhet për shërbimet e tilla.
- 4 Çfarëdo marrëveshje apo ofertë e bërë nga OSSH-ja duhet të jetë në pëlqim me Ligjet e Kosovës, Kodin e shpërndarjes, licencën apo ndonjë rregull tjetër të lëshuar nga Rregullatori.



PJESA IV – KYÇJA NË SISTEM

Neni 11

Metodologjia e përcaktimit të taksave: kërkesat minimale

- 1 Metodologjia e përcaktimit të taksave duhet të përgatitet në mënyrë që t'i mundësojë shfrytëzuesve të sistemit që të bëjnë një vlerësim të arsyeshëm mbi taksat e aplikueshme të kyçjes.
- 2 Metodologjia e përcaktimit të taksave duhet të përfshijë,
 - a) listën ku janë cekur këto pika (përfshirë kryerjen e punëve dhe ofrimin dhe instalimin e linjave elektrike, impianteve apo njehsorëve) të kostove domethënëse, të cilat mund të kërkohen për qëllime të kyçjeve (në pikat hyrëse dhe dalëse) të sistemit të shpërndarjes për të cilat mund të paguhen taksa për kyçje dhe, sipas mundësisë, përfshijnë ngarkesa indikative kundrejt çdo pike të cekur në listë ose (nëse kjo nuk është e mundur) bazën mbi të cilën këto ngarkesa do të llogariten;
 - b) bazat mbi të cilën do të llogariten ngarkesat kundrejt zgjerimit apo përforcimit të sistemit të shpërndarjes të cilën OSSH-ja beson, në mënyrë të arsyeshme, se janë të domosdoshme për t'i ofruar një kyçje parashtruesit të kërkesës pa rrezikuar stabilitetin apo sigurinë e sistemit, apo cilësinë e furnizimit të shfrytëzuesve ekzistues të sistemit;
 - c) bazën mbi të cilën do të llogariten ngarkesat ku sigurimi i linjave elektrike apo impiantit që duhet të instalohen janë të kapacitetit më të madh sesa që nevojitet për nevoja të parashtruesit të kërkesës;
 - d) bazën mbi të cilën do të llogariten ngarkesat për mirëmbajtje dhe riparim të linjave të energjisëelektrike, impiantit apo njehsorëve të instaluar për qëllime të sigurimit të lidhjes;
 - e) bazën mbi të cilën do të llogariten taksat në raport me de-energizimin e kyçjes së konsumatorit, çkyçjen nga sistemi i shpërndarjes të OSSH-së dhe largimin e linjave elektrike, impiantit dhe njehsorëve pas çkyçjes.
 - f) kriteret mbi të cilat merret vendimi i OSSH-së për të refuzuar qasjen në sistem, kritere këto të cilat do të jenë objektive dhe teknikisht e ekonomikisht të arsyeshme.
- 3 Për t'iu shmangur dyshimit, në rastet kur asetet janë paguar nga kontributet e konsumatorit për koston e kyçjes, vlera e atyre asetëve do t'i shtohet bazës së asetëve të rregulluara të të licencuarit por shumata e kontributeve të konsumatorit do të zbritet nga të hyrat e lejuara të të licencuarit.
- 4 Metodologjia duhet të përfshijë një listë të të gjitha informatave të cilat kërkohen nga parashtruesi i kërkesës që kërkon kyçje në Sistemin e shpërndarjes, përfshirë edhe formularët mostra të cilat parashtruesit e kërkesës duhet t'i plotësojnë.



5 Metodologjia e aprovuar duhet të botohet, para hyrjes në fuqi, në ueb faqen e OSSH-së dhe do të lejohet shkarkimi i saj nga parashtrues të mundshëm të kërkesave, ndërsa kopjet fizike duhet t'iu vihen në dispozicion pa pagesë parashtruesve të kërkesave të cilat nuk kanë qasje në media elektronike.

Neni 12

Kyçja e gjeneratorit

1 Parashtruesit e kërkesës për kyçje të gjeneratorit të ri, apo rritjes së kapacitetit të kyçjes për gjeneratorin ekzistues, duhet të paguajnë ngarkesa të cekëta të kyçjes, të përcaktuara ashtu që të mundësojnë mbulimin e kostove direkte për sigurimin e kyçjes në pikën më të afërt të përshtatshme në sistemin e shpërndarjes, përfshirë edhe transformatorët për matje dhe ato për ngritje të një niveli, të domosdoshme për të mundësuar kyçje, por nuk duhet të përfshijnë koston e përforcimit të sistemit e cila mund të rezultojë nga ndonjë kyçje në ndonjë pikë para vetë pikës për kyçje.

2 Në bazë të Nenit 8 të “Rregullës për mbështetjen e energjisë elektrike për të cilën është lëshuar certifikata e origjinës dhe procedurat për pranim në skemën mbështetëse”, OSSH-së i lejohet të kërkojë pagesë, e cila do të miratohet nga Rregullatori, përkritazi me kërkesat e parashtruara për kryerjen e vlerësimit të ndikimit të zhvillimit të propozuar të njësisë së caktuar të gjenerimit e cila do të lidhet në rrjetin e shpërndarjes.

Neni 13

Kyçjet e ngarkesave

1 Për konsumatorë të rinjë të ngarkesës së TU, duhet të përcaktohen taksat standarde të kyçjes për të mbuluar kostot mesatare të ndërprerjes së shërbimit dhe matjes. Parashtruesi i kërkesës duhet të paguajë ngarkesën standarde ku pika matëse për konsumatorin nuk është më larg se [50] metra nga pika më e afërt e përshtatshme e kyçjes në sistemin e shpërndarjes.

2 Ngarkesat jo-standarde duhet të aplikohen kur:

- a) pika matëse e një konsumatori të TU është më larg se 50 metra nga pika më e afërt e përshtatshme për kyçje në sistemin e shpërndarjes, dhe
- b) për të gjithë konsumatorët që nuk janë në TU.

3 Ngarkesat jo standarde që përcaktohen me Nenin 13.2 duhet të përcaktohen në bazë të:

- a) rikthimit të koston për kyçje të thellë, ku:



- i. një ngarkesë e re apo rritja në ngarkesë tejkalon 3% të kapacitetit ekzistues efektiv në pikën e kyçjes në rrjetin e shpërndarjes, dhe
 - ii. kyçja nuk është paraparë në Planin për zhvillim të shpërndarjes, ose
- b) mbulimi i kostos për kyçje të cekët, ku:
 - i. një ngarkesë e re apo rritja në ngarkesë nuk tejkalon 3% të kapacitetit ekzistues efektiv në pikën e kyçjes në rrjetin e shpërndarjes, ose
 - ii. kyçja parashihet në Planin për zhvillim të shpërndarjes.

Neni 14

Përcaktimi i taksave për kyçje

- 1 OSSH parashtron Metodologjinë e vet për përcaktimin e taksave për kyçje për aprovim te Rregullatori në përputhje me Pjesën V të Rregullit të përcaktimit të çmimit dhe me parimet e përcaktimit të ngarkesës.
- 2 Sa më shpejtë të jetë e mundur pas aprovimit të Metodologjisë, OSSH duhet të parashtron për aprovim Rregullatorit deklaratën e taksave të tij për kyçje të llogaritura në përputhje me Metodologjinë.
- 3 OSSH-ja duhet t'i parashtrojë një deklaratë të ngarkesave të tij Rregullatorit për aprovim (nëse propozohet ndryshim i ngarkesave apo jo) të paktën një herë në vit.
- 4 Ngarkesat nuk hyjnë në fuqi para se të aprovohen nga Rregullatori. Rregullatori do t'i aprovoj ngarkesat apo do të ofroj arsye për mos aprovimin e tyre brenda 60 ditëve nga data e dërgimit të ngarkesave të tilla te Rregullatori.

Neni 15

Oferta e Kushteve për kyçje

- 1 Në rastet kur OSSH ka pranuar kërkesë formale për kyçje me të gjitha informatat e nevojshme sipas Metodologjisë së aprovuar për përcaktim të ngarkesave, ai jep ofertë formale për të kyçur parashtruesin e kërkesës brenda afateve kohore të parapara me Nenin 9.7 të Kushteve të përgjithshme të furnizimit me energji. Me kërkesë të personit të interesuar për një kyçje të re apo të modifikuar, OSSH-ja duhet të ofron një pro-faturë indikative dhe jo-obliguese për të ndihmuar personin që të hartojë buxhetin lidhur me kostot financiare të këtij projekti.
- 2 Oferta formale duhet të përmban datën deri kur do të përfundojnë punët e kyçjes.



3 Në rastet kur OSSH-ja dhe parashtruesi i kërkesës pajtohen, oferta formale mund të përmbajë kushtet për pagesat e interesit për moskryerjen nga cilado palë të punëve të domosdoshme apo të ofrojnë pëlqime të domosdoshme e të cilat çojnë në vonesa dhe kosto për palën tjetër.

4 Çfarëdo pro-fature indikative e përgatitur në përputhje me pikën 1 më lartë, nuk duhet të obligon OSSH-në që të:

a) bëjë studime të lokacionit apo studime të sistemit, ose

b) të merr pro-faturë të furnitorëve për linjat, impiantet apo pajisjet e domosdoshme që mund të nevojiten për të mundësuar realizimin e kyçjes, apo për të marr ndonjë të drejtë transferimi

dhe OSSH-ja nuk duhet të obligohet që të bëjë hapat e parapara në pikat a) ose b) më lartë deri në pranimin e kërkesës formale për kyçje.

5 Çfarëdo marrëveshje apo ofertë e bërë nga OSSH-ja duhet të jetë në pajtim me Ligjet e Kosovës, Kodin e shpërndarjes, licencën e tij apo ndonjë Rregull tjetër të lëshuara nga Rregullatori.



PJESA V - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Gjuha zyrtare

Këto Parime janë nxjerrë në gjuhën shqipe dhe do të përkthehen në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes mes versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Neni 17

Ndryshimet

ZRRE mban të drejtën që ta ndryshojë ose ta modifikojë çdo dispozitë të këtyre Parimeve pas procesit të rishikimit të konsultimit publik.

Neni 18

Interpretimi

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e këtyre Parimeve, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar